

LIGJ
Nr.8391, datë 28.10.1998

PËR SHËRBIMIN INFORMATIV TË SHTETIT

(Ndryshuar me ligjin nr. 8479, datë 29.4.1999; nr. 9400, datë 12.5.2005; nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 8479, datë 29.4.1999)

Shërbimi Informativ i Shtetit (SHISH) është organ informativ në funksion të sigurisë kombëtare, që vepron në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Shërbimi Informativ i Shtetit siguron informacionin e domosdoshëm nga zbulimi dhe kundërzbulimi për problemet që lidhen me sigurinë kombëtare.

SHISH-i ushtron veprimtarinë e vet duke përdorur mënyra dhe mjete të ligjshme.

Neni 3

(Ndryshuar togfjalësh me ligjin nr. 8479, datë 29.4.1999; ndryshuar tre nëndarjet e para të paragrafit të parë, shtuar dy nëndarje me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Shërbimi Informativ i Shtetit ka këto detyra kryesore:

- Mbledh informacion brenda dhe jashtë vendit në funksion të sigurisë kombëtare, sigurisë kolektive dhe sfidave globale.
- Mbledh informacion për kërcënimet që vijnë nga aktiviteti i shërbimeve të inteligjencës së huaj, në të gjitha format që shprehet dhe shfaqet, në funksion të ruajtjes së integritetit, pavarësisë dhe rendit kushtetues.
- Mbledh informacion për terrorizmin dhe ekstremizmin, krimet kundër mjedisit, prodhimin dhe përhapjen e armëve të dëmtimit në masë, si dhe për stabilitetin e brendshëm dhe rajonal.
- Mbledh informacion për kërcënimet ndaj sigurisë ekonomike, kërcënimet kibernetike dhe kërcënimet hibride, me impakt në mjedisin e sigurisë së vendit.
- Mbledh informacion për kërcënimet ndaj infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të Republikës së Shqipërisë.
- Mbledh informacion për krimin e organizuar, që cenon sigurinë kombëtare.
- Mbron sigurinë e veprimtarisë së vet, të informacionit, të punonjësve dhe të pasurisë me mjete të përshtatshme, duke përfshirë verifikimin e kualifikimin e kandidatëve, të të

punësuarve e të kontraktuesve.

- Kryen veprimtari mbështetëse tekniko-administrative, sipas nevojave për realizimin e funksioneve të mësipërme.

Për realizimin e detyrave të mësipërme Shërbimi Informativ i Shtetit ruan raporte të drejta ndërmjet nevojës së sigurimit të informacionit të domosdoshëm dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Ligjshmëria, objektiviteti dhe sekreti janë parimet bazë të punës së këtij organi.

Neni 4

Shërbimi Informativ i Shtetit është institucion qendror, që varet nga Kryeministri.

Neni 5

(Ndryshuar togfjalësh dhe shtuar fjali me ligjin nr. 8479, datë 29.4.1999; shfuqizuar nëndarja e fundi e paragrafit të tretë, shtuar dy paragraf në fund të nenit me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Shërbimi Informativ i Shtetit drejtohet nga Drejtori, i cili përgjigjet për veprimtarinë e tij.

Drejtori e zëvendësdrejtori i tij emërohen e shkarkohen nga Presidenti i Republikës me propozim të Kryeministrit. Punonjësit e tjerë emërohen e shkarkohen nga Drejtori i SHISH-it.

Drejtori i SHISH-it ka këto detyra:

- Informon dhe raporton te Presidenti i Republikës dhe te Kryeministri për probleme që lidhen me sigurinë kombëtare.

- Përgjigjet për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacionit, i cili duhet të jetë objektiv dhe i pavarur nga konsideratat politike.

- Mbron metodat dhe burimet e informacionit nga ndërhyrjet e paautorizuara.

- Shfuqizuar.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i SHISH-it përfitojnë pagë bazë, shtesë për vjetërsi dhe shtesë për natyrë të veçantë pune. Trajtimi financiar i tyre përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Drejtori dhe zëvendësdrejtori trajtohen nga legjislacioni për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit.

Neni 6

(Hequr fjalë në paragrafin e fundit me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Shërbimi Informativ i Shtetit e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me procedurat e hartuara nga Drejtori dhe të miratuara nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë. Prokurori i Përgjithshëm ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi zbatimin e këtyre procedurave.

Këto procedura përcaktojnë:

a) mënyrat e sigurimit të informacionit nga zbulimi dhe kundërzbulimi;

b) përdorimin e teknikave të kontrollit fizik dhe elektronik;

c) format e nevojshme për të mbrojtur metodat dhe burimet e zbulimit dhe të kundërzbulimit nga ndërhyrjet e paautorizuara;

ç) rrugët për verifikimin dhe vërtetimin e burimeve të informacionit;

d) mbledhjen e informacionit në lidhje me personat që parashikohet të jenë burime informacioni.

Ndalohet përdorimi i këtyre procedurave ndaj deputetëve të Kuvendit, pa marrë më parë

autorizimin me shkrim nga Kryetari i Kuvendit Popullor dhe ndaj anëtarëve të Këshillit të Ministrave, pa marrë më parë autorizimin me shkrim nga Kryeministri.

Neni 7

(Hequr fjalë në paragrafin e parë me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Veprimtaria e Shërbimit Informativ të Shtetit kontrollohet nga Kuvendi nëpërmjet komisionit përgjegjës për sigurinë të ngritur për këtë qëllim.

Drejtori i raporton komisionit të paktën një herë në vit.

Raportimet në këtë komision bëhen në mënyrë të tillë që të mbrohen burimet dhe informacioni i klasifikuar.

Drejtori i Shërbimit Informativ të Shtetit raporton edhe në Këshillin e Ministrave, sipas përcaktimit të Kryeministrit.

Neni 8

Shërbimi Informativ i Shtetit ka buxhetin e tij vjetor.

Aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përdorimin dhe kontrollin e fondeve publike nuk zbatohen për veprimtari specifike operative të SHISH-it. Përdorimi dhe kontrolli i fondeve të kësaj veprimtarie rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Komisioni përgjegjës për sigurinë, i ngritur sipas nenit 7, ka të drejtë të kontrollojë përdorimin e këtyre fondeve.

Neni 9

Shërbimi Informativ i Shtetit nuk kryen veprimtari të karakterit ushtarak ose policor.

Kur SHISH-i krijon bindjen për një shkelje të ligjit, informon në institucionin përkatës, duke mbrojtur burimet dhe metodat informative.

Shërbimi Informativ i Shtetit në funksion të realizimit të detyrave të tij mund të bashkëpunojë me shërbimet informative të vendeve të tjera.

Neni 10

(Ndryshuar fjali me ligjin nr. 9400, datë 12.5.2005; shtuar fjalë në fund të paragrafit të parë, shtuar paragraf me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Shërbimi Informativ i Shtetit përjashtohet nga detyrimet që kërkojnë publikimin e metodave të punës dhe të burimeve të informacionit, të informacionit të klasifikuar, të strukturave, të funksioneve, të emrave, të titujve zyrtarë, të pagave e të numrit të personelit si dhe nga detyrimet që rrjedhin nga ligji për të drejtën e informimit.

Punonjësit e SHISH-it përjashtohen nga detyrimi për deklarimin e të ardhurave të përftuara nga paga, si dhe deklarimin e kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë. Kontrolli vjetor i tyre kryhet nga struktura e posaçme në Shërbimin Informativ të Shtetit, sipas procedurave të përcaktuara me akt të brendshëm të drejtorit të SHISH-it.

Veprimtaria informative e SHISH-it mbështetet me strukturat legale dhe të fshehta.

Punonjësit e SHISH-it gëzojnë statusin e tyre. Punonjësit e SHISH-it detyrohen të ruajnë sekretin shtetëror dhe të nënshkruajnë një deklaratë për këtë qëllim. Detyrimi i ruajtjes së sekretit vazhdon edhe pasi punonjësi shkëput marrëdhëniet e punës.

Për dhënien e informacionit të klasifikuar personave të paaautorizuar, punonjësit e SHISH-it mbajnë përgjegjësi, sipas ligjeve në fuqi.

Në funksion të realizimit të detyrave, që rrjedhin nga ky ligj, me qëllim kamuflimi, SHISH-i mund të ketë dhe të administrojë pasuri dhe aktivitetet ekonomike, si dhe mund të integrohet në institucionet e tjera shtetërore.

Neni 11

Shërbimi Informativ i Shtetit është organ i depolitizuar.
Punonjësit e tij detyrohen të nënshkruajnë e të zbatojnë deklaratën e departizimit.

Neni 12

Këshilli i Ministrave emëron një inspektor të përgjithshëm përgjegjës për kryerjen e inspektimeve në veprimet e SHISH-it. Emërimi i tij bëhet në përputhje me standardet e sigurimit dhe të përvojës së mëparshme në këtë fushë.

Inspektori i përgjithshëm i raporton drejtpërsëdrejti Kryeministrit dhe është nën varësinë e Drejtorit të SHISH-it. Drejtori i SHISH-it mund ta ndalojë inspektorin e përgjithshëm nga ndonjë inspektim, nëse ai e sheh të domosdoshme një gjë të tillë për mbrojtjen e interesave të sigurisë kombëtare, duke informuar menjëherë Kryeministrit.

Inspektori i përgjithshëm ka të drejtë të ushtrojë kontroll mbi veprimtarinë e SHISH-it. Inspektori i përgjithshëm informon Drejtorin e SHISH-it për shkeljet e ligjit dhe për probleme të tjera serioze që mund të hasen në veprimtarinë e SHISH-it, rekomandon veprime korrigjuese dhe merr përsipër mbrojtjen e informacionit të klasifikuar gjatë përgatitjes së raportit.

Neni 13

(Shtuar paragraf me ligjin nr. 64/2026, datë 2.7.2026)

Organizimi dhe struktura e Shërbimi Informativ i Shtetit miratohen nga Kryeministri.

Funksionimi i brendshëm i SHISH-it rregullohet nëpërmjet akteve normative të miratuara nga Drejtori i SHISH-it.

SHISH-i bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore në zbatim të këtij ligji, duke u dhënë informacion deri në atë masë që lejon mbrojtja e burimeve dhe e metodave të punës.

Punonjësit e SHISH-it kanë të drejtë të kërkojnë informacion për përmbushjen e detyrave në funksion të sigurisë kombëtare nga drejtuesit e institucioneve qendrore, lokale, personat fizikë e juridikë shtetërorë ose privatë.

SHISH-i ka detyrimin e sigurimit të fshehtësisë së këtij informacioni, i cili përbën sekret shtetëror.

SHISH-i mund të kontraktojë me institucione, persona të tjerë juridikë e fizikë për përmbushjen e detyrave, në përputhje me standardet e sigurimit, të përcaktuara nga Drejtori i tij.

SHISH-i ka të drejtë për akses në bazat e të dhënave shtetërore, i cili është i kufizuar sipas funksionit ligjor dhe rregullohet me marrëveshje ndërinstitucionale.

Neni 14

Për të realizuar qëllimin në funksion të sigurisë kombëtare, Shërbimi Informativ i Shtetit bashkërendon dhe drejton punën për grumbullimin e shkëmbimin e informacionit me shërbimet informative të strukturave të tjera shtetërore, të parashikuara me ligj.

Neni 15

Punonjësit e Shërbimi Informativ të Shtetit kanë këto detyra dhe të drejta:

- Zbatojnë urdhrat e Drejtorit apo të çdo eprori, që nuk bien në kundërshtim me këtë ligj.

- Zbatojnë rregullat e etikës të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

- Gëzojnë të drejtën e ndihmës së ligjshme dhe të përshtatshme nga SHISH-it, si gjatë ushtrimit të detyrës, ashtu edhe kur kanë shkëputur marrëdhëniet me të, kur ndaj tyre vepron një akt kriminal për shkak të detyrës që kryejnë ose kanë kryer. Nuk e përfitojnë këtë ndihmë në rast se veprojnë jashtë autoritetit të SHISH-it ose abuzojnë me detyrën.

- Përfitojnë nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi për punësimin, ndihmë mjekësore, pensionin dhe të drejta të tjera.

Përveç kushteve dhe kriterëve për punësim që zbatohen në institucionet e tjera, për punonjësit dhe kandidatët e SHISH-it përcaktohen edhe kushte të veçanta në interes të sigurisë kombëtare.

- Me akte nënligjore mund të jepen përfitime ose leje të veçanta për punonjësit e SHISH-it, lidhur me shpërblimet, udhëtimet e autorizuara zyrtare, veprimet për sigurimin fizik, kryerjen e veprimeve operative, kur pagesa e këtyre shërbimeve është e domosdoshme për të përmbushur detyrat funksionale.

- Drejtori i Shërbimi Informativ i Shtetit autorizon njësi të veçanta të mbajnë armatim gjatë ushtrimit të detyrës, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 16

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Drejtori i Shërbimi Informativ të Shtetit të nxjerrin aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 17

Ligji nr.7495, datë 2.7.1991 "Për organizimin e Shërbimit Informativ Kombëtar", shfuqizohet.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.